



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
KABINETI

Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania - Tel/Faks. +355 4 36462937 - www.moh.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2010

Lënda : Realizimi i treguesve të monitorimit financiar për Ministrinë e Shëndetësisë për 9 mujorin 2010.

Drejtuar : MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJTHSHME TË BUXHETIT

Në zbatim të Ligjit Nr.9936 date 26.6.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" dhe ", Ligjit Nr.10190 date 26.11.2009 "Per buxhetin e vitit 2010", ne zbatim te Udhezimit Nr. 1 date 21.1.2010 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010 bashkëlidhur ju dërgojmë informacionin për realizimin e buxhetit të nentemujorit 2010.

Në kollonën e buxhetit të vitit 2010 është shënuar buxheti vjetor ndërsa për sa i përket faktit të dhënat janë 9 mujore.

Shpenzimet buxhetore për 9 mujorin e parë të vitit 2010 për sektorin shendetesor paraqiten me nje realizim prej 72%.

Sipas programeve buxhetore realizimi paraqitet si vijon:

- Programi planifikim menaxhim administrim 64%
- Programi Sherbime te kujdesit shendetesor paresor 74%
- Programi Sherbime te kujdesit shendetesor dytesor 73%
- Programi sherbime te shendetit publik 63%.

Po te analizojme realizimin sipas artikujve buxhetore ato paraqiten si vijon:

Paga 66%, sigurime 71%, shpenzime operative 55%, transferta e ISKSH 73% .

Aktualisht jane zbatuar te gjitha VKM te rritjes se pagave per punonjesit e sistemit shendetesor.

Për sa i përket realizimit të artikullit mallra dhe shërbime pjesa më e madhe e fondeve të këtij artikulli ne sherbimin spitalor prokurohen nga vete spitalet.

Plani i investimeve nga buxheti i shtetit per 9 mujorin pas te gjithë transferimeve te miratuara deri me 30.9.2010 eshte 1.581.215 mije leke, ndersa realizimi sipas raportimeve nga institucionet e varesise eshte 1.156.457 mije leke. Pra per 9 mujorin realizimi i investimeve paraqitet ne masen 74%.

Sipas programeve buxhetore realizimi i investimeve paraqitet si vijon:

- Programi Planifikim Menaxhim Administrim

Plani per kete program eshte 43.968 mije leke, realizimi 33.786 mije leke ose baraz me 78%. Diferenca e pafinancuar vjen nga mosfinancimi deri ne kete moment i tenderit "Blerje pajisje mobilimi per Aparatin e Ministrise se Shendetesise" ne vleren 4.206 mije leke. Pritet likujdimi .

Vlere tjeter eshte edhe pagesa e kosos lokale per njesine e zbatimit te projekteve nga totali i planit 5.000 mije leke eshte financuar 1.713 mije leke. Deri ne fund te vitit edhe ky financim do te realizohet.

- Programi Sherbime te Kujdesit Shendetesor Paresor

Plani eshte 278.866 mije leke ndersa financimi per 9 mujorin eshte 94.897 mije leke baraz me 34%. Kjo diference e konsiderueshme ne financim vjen per arsye:

1. Ne kete program jane kryer disa prokurime te perqendruara ne Ministrine e Shendetesine per te cilat jane perfunduar te gjitha procedurat e lidhjes se kontrates dhe ka filluar levrimi i mallit.
2. Deri ne fund te muajit nentor do te kryhet financimi per blerje unite dentare me vlere 7.200 mije leke, blerje pajisje mobilimi per qendrat shendeteosre dhe ambulancat me vleren e prokuruar 26.000 mije leke etj.
3. Influence negative ne mosrealizim kane krijuar edhe disa mosfinancime nga institucionet te situacioneve pjesore duke pritur perfundimin e punimeve .

Mos realizim dhe mos financim ka edhe ne zerin TVSH dhe kosto lokale. Ne kete program plani eshte 198.590 mije leke, ndersa financimi deri me 30.9.2010 eshte 59.270 mije leke. Nga diferenca e pafinancuar prej 139.319 mije leke shuma 63.000 mije leke eshte rialokuar per disa objekte te tjera prioritare.

- Programi Sherbime te Kujdesit Shendetesor Dytesor

Plani ne total per kete program eshte 1.239.331 mije leke, ndersa financimi eshte 1.017.710 mije leke, ose baraz me 83%. Jemi te mendimit qe deri ne fund te vitit diferenca e pa financuar do te financohet.

- Programi Sherbime te Shendetit Publik

Plani eshte 19.050 mije leke ndersa financimi deri me 30.9.2010 eshte 10.063 mije leke, baraz me 53%. Ne kete realizim te ulet ka ndikuar pezullimi i procedurave te prokurimit . Jemi te mednimit qe deri ne fund te vitit do te likujdohet shuma e prokuruar.

Bashkelidhur gjeni informacionin mbi ecurine e financimeve te investimeve te huaja.

Duke ju falenderuar,

SEKRETARE E PERGJITHSHME
MIRELA CANO

Informacion mbi projektet me financim te huaj

I. Projekti i Spitalit te Pergjithshem te Kavajes - ALB019

Projekti i Spitalit të Përgjithshëm të Kavajes është një projekt i cili financohet në mënyrë të përbashkët prej Qeverisë shqiptare-10% dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB)- 90% sipas Marrëveshjes së Kredës së lidhur me Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Islamike për Zhvillim me referencë **ALB019** e ratifikuar me Ligjin nr.9394, datë 12.05.2005 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredës ndërmjet Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Islamike për Zhvillim për projektin e Spitalit të Përgjithshëm të Kavajes”.

Vlera e projektit afërsisht 8.76 milion USD

Objektivi i projektit : Ndërtimi dhe paisja e spitalit Kavaje

Kontrata e zbatimit të punimeve civile është realizuar në masën 95%.

Aparaturat mjekësore, mobileria, autoambulancat dhe IT kanë mbërritur tërësisht në objekt.

Mbetet për të realizuar sistemin e kanalizimit të ujërave.

II. Projekti i Spitalit te Pergjithshem Durres (Faza II) – ALB 018

Projekti për Fazën e II të Spitalit të Përgjithshëm Durrës është një projekt i cili financohet në mënyrë të përbashkët prej Qeverisë shqiptare dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB). Të gjitha komponentet e kësaj Marrëveshje të Kredës së lidhur me Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Islamike për Zhvillim me referencë **ALB018** e ratifikuar me Ligjin nr.9234, datë 20.05.2004 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredës ndërmjet Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës Islamike për Zhvillim për projektin e Fazës së II të Spitalit të Përgjithshëm të Durrësit”.

Vlera e projektit 8.23 milion USD

Objektivi: Ndërtimi dhe paisja e spitalit të Durrësit Faza II

Projekti është finalizuar dhe dorëzuar pranë Drejtorisë së Spitalit Rajonal Durrës.

III. Projekti Ndërtimi i Spitalit te Semundjeve te brendshme QSU Tirane(Faza I)

Projekti për Fazën e I të QSUT, është një projekt i cili financohet në mënyrë të përbashkët prej Qeverisë Shqiptare 37% dhe Bankës së Keshillit të Europës CEB – 63% sipas Marrëveshjes së Kredës së lidhur me Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës së Keshillit të Europës me referencë FP/1515 e ratifikuar me Ligjin nr.9412, datë 20.05.2005 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredës ndërmjet Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës së Keshillit të Europës për Projektin e Fazës së Parë të QSUT”.

Vlera e projektit 21.4 milion usd

Kreda disbursohet me transhe disbursimi, të cilat vetëm kur amortizohet në masën 90%, mund të disbursohet transhi pasardhës. Deri më tani janë disbursuar 4 transhe. Vonese në likuidimin e Kostos Lokale dhe TVSH së mbartur që nga viti 2009.

Është realizuar lidhja me infrastrukturen e Qendrës Spitalore Universitare, është instaluar kabina elektrike nga KESH

Gjithashtu janë kontraktuar edhe komponenti i Pasijeve Mjekesore, të financuara nga buxheti i shtetit në Shumen prej 8 milion Euro nga Qendra Univesitare Nene Tereza Tirane. Ka përfunduar instalimi i paisjeve.
Pritet të disbursohet 5% i garancisë.

IV. Projekti i Ndertimit të Spitalit të Shkodrës (Faza III)

Projekti për Rehabilitimin e Spitalit Rajonal Shkoder Faza e Tretë është një projekt i cili financohet në mënyrë të përbashkët prej Qeverisë shqiptare dhe Bankës së Keshillit të Europës. Marrëveshje e Kredës është lidhur me Keshillit të Ministrave të RSH dhe Bankës së Keshillit të Europës është ratifikuar Ligji Nr. 10004, dt.9/10/2008 dhe si më poshtë është ndarja e kontributit sipas donatoreve.
Vlera e Projektit 8.23 milion USD

Objekti i projektit Ndertimi dhe rehabilitimi për Spitalin Rajonal Shkoder Kontrata e zbatimit të punimeve civile është lidhur me firmën fituese Kontraktore me Gusht 2010 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe shoqërisë ESI Consorzio Stabile për punime ndertimi dhe rehabilitimi me një sipërfaqe totale prej 16,000 metra katrorë. Kontrata e ndertimit parashikon punime paralele në tre objekte, ndertime të reja dhe rehabilitime të godinave egzistuese. Punimet deri në tani po zbatohen sipas grafikut të punimeve.
Përsa i takon paisjeve Mjekesore dhe Furniturave, këto do të financohen 100% nga buxheti i shtetit në vlerën prej 1 milion euro për vitin 2011.
Projekti vazhdon.

V. Projekti Modernizimi i Sistemit Shëndetësor në Shqipëri

Projekti **Modernizimi i Sistemit Shëndetësor në Shqipëri**, financohet nga Shoqata Nderkombetare për Zhvillim (IDA) si dhe me bashkefinancim nga Qeveria Japoneze në formën e një granti nga të cilat financimi nga IDA parashikohet të jetë 15,4 milion USD, kontributi nga Qeveria Japoneze të jetë 1,6 milion USD si dhe kontributi i Qeverisë Shqiptare për projektin të jetë 2,4 milion USD.
Vlera e këtij projekti të rëndësishëm është përlogaritur të jetë afërsisht 19.4 milion USD

Në kuadër të këtij projekti vlen për tu përmenduar që të gjitha aktivitetet e parashikuara për tu financuar nga Qeveria Japoneze (financim që është pjesë integrale e këtij projekti), janë realizuar në masën 82%.

Ka filluar implementimi "*skicimi i sistemit të informacionit*" për Institutin e Sigurimeve Shëndetësore.

Banka Botërore ka miratuar një shtyrje projekti përtej afatit zyrtar të mbylljes së tij (30 shtator 2010) prej 18 muajsh (deri më 31 Mars 2012)

Në nëndor 2011 pritet vlerësimi i tenderave:

- Paisje informatike
- Data warehouse

VI Projekti Blerje paisje pajisjeve mjekesore për Su 'Shefqet Ndroqi »

Kontrata është e lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë (Bleresi) dhe AME International Austri përfaqësuar nga Z. Heinz Messinger Drejtor i përgjithshëm (Shitesi).

Vlera e kontratës 7.488 milion Euro .

Kontrata e firmosur ne date 30.04.2009

Koha e realizimit te Kontrates 18 Muaj.

Kontrata eshte e perbere nga 34 artikuj, nga te cilet jane levruar marre ne dorezim dhe jane ne funksion 33 cope prej tyre, priten dhe 1.

VII Projekt Fuqizimi i Përgjigjes Kombëtare të Shqipërisë ndaj HIV/AIDS-s ndër Grupet Vulnerabil

Vlefte totale 4,936,229 usd. Projekti bashkefinancuar nga Qeveria Shqiptare ne vlefte 182,410 usd. Donatori i projektit eshte Fondi Global per te luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarjen.

Shqiperia nepermjet Institutit te Shendetit Publik aplikoi dhe fitoi ne Raundin e Peste te aplikimeve prane Fondit Global. Dy grantet u bene efektive perkatesisht ne vlerat 4,936.229 USD dhe 1,263.490 USD.

Per shkak te performances shume te mire te ecurise programtike dhe financiare te implementimit te granteve ne vitin 2009 ISHP dhe PIUGFTAM fituan te drejten e vazhdimit te fazes se dyte te projektit. Qeveria miratoi ne parim marreveshjet e grantit perkatesisht nepermjet VKM 765 DT 8.7.2009 dhe VKM 766 DT 8.7.2009. PIU eshte tashme ne implementimin e vitit te fundit te projektit.

VIII Titulli i projektit Fuqizimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Tuberkulozit

Vlera totale e projektit US\$ 1,263,490, financimi nga Qeveria Shqiptare \$ 120,027

Ecuria e projektit eshte shume e kenaqshme. Asnje problematike e evidentuar deri me sot.

IX. Projekti “Rikonstruksioni dhe Paisjet per 5 poliklinika

Bazuar ne Ligjin Nr.9238 date 10.06.2004 “Per ratifikimin e marreveshjes ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Italise per realizimin e programit Rehabilitimi dhe Pajisja e 5 Poliklinikave”, eshte akorduar nje kredi e bute prej 5.080.000 euro, per te bere te mundur te gjitha aktivitetet e projektimit, realizimit dhe monitorimit.

Gusht 2008 filluan punimet per ristrukturimin e Poliklinikes se qytetit te Korçes, te cilat kane perfunduar eshte duke u kryer kolaudimi nga drejtoria e spitalit Korce. Diferenca prej rreth 22.000 euro nga totali i kontrates se lidhur do te disbursohet me t'u dorezuar proces-verbali i kolaudimit.

Eshte zhvilluar ne v.2009 gara me objekt: “Rikonstruksionin e Poliklinikave Gjirokaster dhe Diber”, me vlere limit 611.475 euro, por qe per arsye te mungeses se konkurrences, kjo gare u anulua. Eshte riderguar dokumentacioni ne Ministrine e Puneve te Jashtme ne Rome per aprovim te botimit te lajmerimit te gares, duke pasqyruar dhe disa ndryshime te kerkuara nga kjo e fundit.

Gjithshka eshte gati per shpalljen e garave per « Furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve mjekesore dhe te mobilimit per polikliniken e qytetit te Korçes, Tiranës » Gjithshtu eshte gati shpallja e gares per “Rikonstruksionin e Poliklinikave Gjirokaster e Peshkopi. Pritet miratimi i dates se gares nga Ministria e Puneve te Jashtme _Rome.

X. Projektin "Forcimi i sistemit te emergjences ne spitalin Shkoder"- grant qeverise italiane

Shenim : Rezultate mbi disbursimet per kete projekt ne si institucion nuk disponojme.

Perpjektet nga ana e institucionit per to ka qene maksimale. Ne jemi drejtuar Minisstrise se Financave si dhe se fundmi Ambasades Italiane si autoritet i vetem i dhenies se informacionit por deri me sot nuk disponojme te dhena.

XI. Projekti Zhvillimi i mjeksise transfuzionale ne Shqiperi sipas Standarteve te Cilesise Europiane

Projekti eshte nenshkruar ne 26.01.2006 nga Ministria e Puneve te Jashtme te Qeverise Italiane dhe Qeverise Shqiptare.

Projekti perfundon me 2010.

- Per palen italiane projekti realizohet nepermjet ESTM (shkolla europiane mjeksise transfuzionale) dhe Departamentit te Planifikimit spitalor ne Ministrine e Shendetesise.

Bashkepunimi per realizimin e projektit arrihet nepermjet :

Binjakezimit te kater qendrave transfuzionale te gjakut ne shqiperi me qendra te njejta ne itali

Qendrat e distinuara per binjakezim ne shqiperi jane QKTGJ-ja dhe qendrat rajonale.

Objekti i projektit Zhvillimi i mjeksise transfuzionale ne Shqiperi sipas Standarteve te Cilesise Europiane

- **Shenim** : Rezultate mbi disbursimet per kete projekt ne si institucion nuk disponojme.

Perpjektet nga ana e institucionit per to ka qene maksimale. Ne jemi drejtuar Minisstrise se Financave si dhe se fundmi Ambasades Italiane si autoritet i vetem i dhenies se informacionit por deri me sot ne nuk disponojme te dhenaShenim

XII. Projekti Permiresimi i qendres se djegjeve te renda ne QSUT dhe mbeshtetja e aktiviteve te kesaj qendre per 12 muaj

Kontrata u nenshkrua ne ne 20 nendor 2008, grand midis QSUT dhe Komisionit European. Financimi eshte realizuar nepermjet Programit te Fqinjesisë Itali-Shqiperi me nje vlere 950.000 euro (100% financim nga asistenca komunitare) Eshte pjese Programit « CARDS 2005 »

Objektiva e projektit Permiresimi i qendres se djegjeve te renda ne QSUT dhe mbeshtetja e aktiviteve te kesaj qendre per 12 muaj.

Nuk ka zhvillime te reja.